



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-019

Prishtinë, më 30 maj 2011, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 30 MAJ 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga Grupet Parlamentare: Adem Grabovci, Myzejene Selmani, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini dhe Rasim Demiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Lejla Selimi.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 maj 2011,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 maj 2011

Kryesia miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 maj 2011.

2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjet plenare që do të mbahet më 03 qershor 2011

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet më 03 qershor 2011, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit nr. 03/l-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/L-8, për verërat,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palëve të treta,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për akcizën në produktet e duhanit,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorim civil të eksplozivëve,
9. Shqyrtimi i Raportit për funksionimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik të Kosovës, për vitin 2010,

10. Rekomandimi i Organit përzgjedhës lidhur me emërimin e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, dhe
11. Propozimi Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, për emërimin e deputetes Suzana Novoberdali, në vend të deputetit Ibrahim Makolli, në Komisionin Parlamentar për ndryshime Kushtetuese.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave:

3.1 Kërkesa e deputetit Ahmet Isufi, i mbështetur nga Grupi i deputetëve nënshkrues, për mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit për rastin e ri-gjykit të pjesshëm të z. Ramush Haradinaj dhe të bashkëlufëtareve të tij, Lahi Brahimaj dhe Idriz Balaj

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e lartcekur, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet më 31 maj 2011, në ora 11:00, me këtë:

R e n d d i t e

1. Debat parlamentar për rastin e ri-gjykit të pjesshëm të z. Ramush Haradinaj dhe Të bashkëlufëtareve të tij, Lahi Brahimaj dhe Idriz Balaj.

3.2 Njoftim për sfidat e Raportit të Progresit 2010 të Komisionit Evropian, që ndërlihdën me punën e Kryesisë dhe të Administratës së Kuvendit të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Administrata e Kuvendit për respektimin e afatit për përmbushjen e veprimeve në pajtim me sfidat e Planit të veprimit.

Pikat shtesë :

- 1. Propozimi Grupit Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re, për emërimin e deputetes Suzana Novoberdali, në vend të deputetit Ibrahim Makolli, në Komisionin parlamentar për ndryshime kushtetuese**

Kryesia u njoftua lidhur me këtë çështje dhe vendosi që propozimi i lartcekur të radhitet në rend të ditës në mbledhjen plenare të radhës, që do të mbahet më 3 qershor 2011.

2. Rekomandimi i Organit përzgjedhës lidhur me emërimin e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik

Kryesia, pasi shqyrtoi Rekomandimin e lartcekur, vendosi që kjo pikë e rendit të ditës të radhitet në rend të ditës në mbledhjen plenare të radhës, që do të mbahet më 3 qershor 2011.

Të ndryshme:

Kryetari i Kuvendit njoftoi Kryesinë lidhur me vizitën e tij të realizuar në Itali.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **12:25** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.